



Agjencia për
Mbështetjen
e Shoqërisë Civile

Adresa:

Rruga "Frosina Plaku",
Nr. 58, Kati II,
Tiranë, Shqipëri

Telefon:

04 22 355 69

E-mail:

info@amshc.gov.al

Website:

www.amshc.gov.al

RAPORT I ZGJERUAR VJETOR

2022



Agjencia për Mbështetjen
e Shoqërisë Civile

RAPORT MBI VEPRIMTARINË E AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE GJATË VITIT 2022

Tabela e përmbajtjes:

KAPITULLI I

- *Vështrim i përgjithshëm*3
- *Organet dhe funksionet e institucionit*4
- *Kuadri ligjor, organizimi strukturor dhe funksionimi i AMShC-së*5

KAPITULLI II.....

- *Zbatimi i Ligjit "Për të Drejtën e Informimit", Ligjit "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik... si dhe Strategjisë Kundër Korrupsionit... 6-7*
- *Analiza dhe statistika të shpërndarjes së granteve të Thirrjes 14 sipas fushave prioritare si dhe shtrirjes territoriale...8-11*
- *Shpërndarja territoriale sipas qarqeve administrative e projekteve fituese*12

KAPITULLI III

- *Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC)*13-14

KAPITULLI IV.....

- *Monitorimi/Vlerësimi i performancës së treguesve Buxhetore për Vitin 2022***Error! Bookmark not defined.**
- *Plani fillestar i Buxhetit Viti 2022*16
- *Rishikimi i Buxhetit*17
- *Vitin 2022 si dhe ndryshimet e ndodhura nga plani fillestar*18-20
- *Analiza e realizimit të treguesve buxhetorë për Vitin 2022*21-25

KAPITULLI V.....

- *Aktivitetet kryesore të AMShC-së për vitin 2022*26-32

KAPITULLI I

Vështrim i përgjithshëm

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, është një ent publik, buxhetor krijuar me Ligjin me nr. 10093 datë 09.03.2009 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”.

AMShC-ja është krijuar me qëllimin për të asistuar me Mbështetje Financiare dhe Teknike Shoqërinë Civile në vend duke qenë e përkushtuar të promovojë, mbështesë dhe mbrojë parimet e dinjitetit njerëzor, lirisë, barazisë, mos-diskriminimit, sundimit të ligjit, respektimin e të drejtave të njeriut, transparencës dhe profesionalizmit.

Një shoqëri civile aktive, e fuqishme dhe gjithë përfshirëse mund të luajë një rol të rëndësishëm për zbatimin në praktikë të këtyre parimeve. Ajo është gjithashtu një komponent thelbësor i çdo demokracie funksionale.

Duke artikuluar shqetësimet e qytetarëve, organizatat e shoqërisë civile, si subjekte jo- shtetërorë, struktura jo-fitimprurëse, në të cilat njerëzit organizohen të ndjekin objektivat dhe idealet e përbashkëta, duhet të jenë gjithnjë e më shumë aktivë për çështje publike si dhe të angazhohen në iniciativa që nxisin pluralizmin dhe pjesëmarrjen në demokraci.

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, në kuadër të politikës së fuqizimit të shoqërisë civile, është përqendruar në stimulimin e demokracisë pjesëmarrëse dhe gjithë përfshirëse.

Kjo reflektohet në përpjekjet për krijimin e një mjedisi që është i favorshëm për aktivitetet e shoqërisë civile dhe ndërtimin e kapaciteteve të OJF-ve për të qenë aktorë të efektshëm, të përgjegjshëm dhe të pavarur, nëpërmjet formalizimit të procedurave transparente dhe jo-diskriminuese të regjistrimit, veprimtarisë së lirë dhe të pavarur, si dhe bashkëpunimit midis qytetarëve etj.

Shoqëria civile, duke pasur struktura të përshatshme dhe mekanizma për bashkëpunim me AMShC-në dhe institucionet e tjera publike, si dhe fluks të lirë, të qartë dhe të arritshme të informacionit mbi çështjet e interesit publik përmes mekanizmave të qëndrueshme dhe të strukturuar, rrit autonominë e saj, atë të përfaqësimit dhe të llogaridhënies, duke forcuar bazën e organizatave sipas standardeve më të larta të qeverisjes së brendshme, nëpërmjet përfshirjes së strukturave demokratike, monitorimit dhe vlerësimit, menaxhimit financiar, transparencës, informimit dhe bashkëpunimit të ndërsjellë.

Organet dhe funksionet e institucionit

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile është krijuar me Ligjin nr. 10093 datë 09.03.2009 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile” dhe ka si mision të saj, nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë civile dhe krijimin e kushteve të favorshme për nisma civile, në të mirë dhe në interes të publikut.

Për përmbushjen e këtij misioni, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile ka si detyrë të saj funksionale që të ofrojë asistencë financiare dhe teknike për programet që nxisin e forcojnë qëndrueshmërinë e organizatave jofitimprurëse; bashkëpunimin ndër-sektorial e ndërkombëtar; nismat civile; filantropi; vullnetarizmin e institucioneve demokratike të shoqërisë civile; si dhe programe të tjera, që lehtësojë përmbushjen e misionit të saj.

AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

ka si objekt të veprimitarisë së saj:

- *nxitjen e bashkëpunimi me OJF-të, që kanë objekt të punës mbikëqyrjen e luftës kundër korrupsionit; luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore e të trajtimit të viktimave të saj; kundër dhunës në familje e kundër dhunës ndaj fëmijëve;*
- *nxitjen e qytetarëve në veprimtari, përfshirja e pjesëmarrja e tyre për zhvillimin e komunitetit;*
- *respektimin e të drejtave të njeriut;*
- *krijimin e konsolidimin e kapaciteteve të shoqërisë civile;*
- *zhvillimin e bashkëpunimit ndër sektorial dhe e bashkëpunimit ndërmjet organizatave të shoqërisë civile;*
- *rritjen e ndikimit publik dhe veprimitarisë së organizatave të shoqërisë civile në vendimmarrje;*
- *zhvillimin e sipërmarrjes shoqërore dhe punësimit në sektorin jofitimprurës;*
- *rritjen e ndikimit të shoqërisë civile në proceset e hartimit dhe të miratimit të politikave publike*
- *përcaktimin e procedurave të zbatueshme për shpërndarjen e fondeve në mbështetje të shoqërisë civile etj.*

Kuadri ligjor, organizimi strukturor dhe funksionimi i AMShC-së

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile funksionon dhe mbështet punën e saj duke u bazuar në një paketë të plotë ligjore, si vijon:

a) Ligji me nr. 10093 datë 09.03.2009 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”. Ky ligj, deri më sot nuk ka pësuar asnjë ndryshim.

b) Vendimi nr. 769 datë 15.07.2009 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e statutit të Agjencisë Për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”.

c) Vendimi nr. 789 datë 16.11.2011 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në Vendimin nr. 769 datë 15.07.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”.

ç) Rregullorja e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, miratuar me vendimin e Bordit Mbikëqyrës në mbledhjen e datës 20.09.2010.

d) Rregullorja e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, e azhurnuar në përputhje dhe përshtatje me ndryshimet e parashikuara në Vendimin nr. 789 datë 16.11.2011 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në Vendimin nr. 769 datë 15.07.2009 të Këshillit të Ministrave, Për miratimin e statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”. Këto ndryshime janë miratuar me vendimin e Bordit Mbikëqyrës në mbledhjen e datës 30.11.2011.

dh) Rregullorja “Mbi procedurat e Financimit me Grante në Mbështetje të Shoqërisë Civile” të miratuar nga Bordi Mbikëqyrës me Vendimin nr. 1 datë 08.07.2010.

e) Rregullorja “Mbi procedurat e Financimit me Grante në Mbështetje të Shoqërisë Civile”, e ndryshuar me vendimin e Bordit Mbikëqyrës në mbledhjen e datës 10.03.2011.

ë) Vendimi nr. 1 datë 08.07.2010 i Bordit Mbikëqyrës të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, nëpërmjet të cilit janë miratuar:

- Formati i Aplikimit.
- Kriteret e Vlerësimit.
- Kontrata Tip

f) Udhëzimin nr. 1 datë 29.12.2010 i Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Për Mbështetjen e Shoqërisë Civile “Për plotësimin e raporteve financiare dhe kontrollin financiar, për efekt të monitorimit të Projekteve të financuara me Grante nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”.

g) Urdhri nr. 161 datë 05.09.2013 i Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile “Për procedurën e administrimit të akteve shpresore, kërkesave/projekt-propozimeve, formimin e dosjeve dhe mënyra e qarkullimit të tyre në AMShC”.

KAPITULLI II

Programi Anti-Korrupsion kornizohet ligjërisht përmes akteve të miratuara nga Qeveria Shqiptare të cilat, në vetvete, sanksionojnë dhe rregullojnë veprimtarinë e Organit Qendror (AMShC-së) sipas parashikimeve të publikuara. Kjo kornizë ligjore shkon paralel me akte të tjera ligjore të cilat nuk çënojnë në zbatimin e tyre zbatimin e misionit të AMShC-së në thelb. E thënë konkretisht, ky

program, është pikë zbatimi i një programi umbrellë i cili inicon dhe vijon prej Kryekoordinatorit të tij – Ministria e Drejtësisë.

Vendimi Nr. 247 datë 20.03.2015 “Për Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit për Periudhën 2015-2020” (i ndryshuar me VKM- nw Nr. 516 datw 01. 07. 2020) i Këshillit të Ministrave, pasqyron qartë gjëndjen në të cilën ndodhet korrupsioni dhe objektivat për realizim të kësaj strategjie të cilat do të ndihmojnë të minimizojnë këtë fenomen në të ardhmen.

Për t’i ardhur në ndihmë kësaj nisme por edhe referuar nevojave të ndryshme të adresuara në këtë prizëm, Qeveria Shqiptare, me Vendimin Nr. 516 datë 01.07.2020 “Për Miratimin e Planit të Veprimit 2018-2020, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2020- 2023 ka sanksionuar twrw veprimtarinw e Organeve Qendrore pwr t’i ardhur nw ndihmw zbatimit tw kwsaj Strategjie.

Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit:

Qëllimet madhore të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (SNKK), janë parandalimi, ndëshkimi dhe ndërgjegjësimi/edukimi rreth korrupsionit.

Kjo Strategji, përmban tre Qasje:

1. Qasjen Parandaluese me:
 - 11 Objektiva të cilat zërthehen në:
 - 21 Indikatorë dhe
 - 57 Masa
2. Qasjen Ndëshkuese me:
 - 4 Objektiva të cilat zërthehen në:
 - 9 Indikatorë dhe
 - 19 Masa
3. Qasjen Ndërgjegjësuere me:
 - 3 Objektiva të cilat zërthehen në:
 - 7 Indikatorë dhe
 - 26 Masa.

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), është pjesë e Strategjisë në zbatimin e Objektivave të Qasjes Ndërgjegjësuere përmes zbatimit të programit C3 “Qasja Ndërgjegjësuere”.

Për realizimin e masave, AMShC, në vitin 2022, realizoi:

- Rishikimin e Programit Anti-korrupsion nga AMShC- ja;
- Raportimin e projekteve të anti-korrupsionit të financuar nga AMShC- ja dhe
- Alokimin e buxhetit në mbështetje të Projekteve të Anti-korrupsionit nga OShC-të.

Sikurse viti 2022, edhe viti 2023, solli produkte edhe më rezultative ndaj kësaj iniciative ku AMShC është pjesë zbatuese e saj duke synuar prodhimin e një sërë materialesh në funksion të ndërgjegjësimit mbi fenomenin e korrupsionit, kështu,

Në mbështetje të projekteve anti- korrupsion, janë alokuar rreth 12 milionë lekë me një vlerë realizimi prej 47, 5 përqind.

Zbatimi i Ligjit "Për të Drejtën e Informimit" si dhe i Ligjit "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik"

❖ Zbatimi i Ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" është përgatitur programi i transparencës për Agjencinë e Mbështetjes së Shoqërisë Civile.

Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së autoritetit në kuadër të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" (LDI).

Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës AMSHC ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale.

Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentin.

Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet.

Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë. Dokumentacioni i bërë publik, do të jetë i përditësuar në formë e përmbajtje.

Faqja zyrtare e AMSHC-së është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm.

Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve / subjekteve të të dhënave, etj.

❖ Zbatimi i Ligjit Nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik"

Takime informuese dhe konsultime publike me OSHC-të lidhur me çështjet:*

- *Nw qaret kryesore tw vendit lidhur me:*
 - *Mbi procesin e përcaktimit të prioriteteve të Thirrjes nr. 15për Projekt-Propozime*
 - *Mbi procesin e përzgjedhjes së katër anëtarëve të rinj të shoqërisë civile të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile*
 - *Mbi Strategjinë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit (SNKK) etj*

* Në mënyrë më të detajuar i gjeni në kapitullin IV

Analiza dhe statistika të shpërndarjes së granteve të Thirrjes 15 sipas fushave prioritare si dhe shtrirjes territoriale

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), në kuadrin e konkurimit të hapur dhe transparent sipas kriterëve të përcaktuara në Ligjin Nr. 10 093, datë 09.03.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, në përputhje me statutin dhe misionin e saj: Asistencë Financiare për një zhvillim të qëndrueshëm të shoqërisë civile dhe krijimin e kushteve të favorshme për nisma qytetare në të mirë dhe interes të publikut; shpalli këtë Thirrje për Shprehje Interesi; Thirrjen Nr.15 (31 Maj-01 Korrik 2022)/për të gjitha OJF-të e interesuara për projekte.

Prioritet e përcaktuara nga Bordi Mbikqyës për Thirrja Nr.15 (31 Maj-01 Korrik 2022)/ishin si më poshtë:

1. 1. Shëndetësia dhe Shërbimet Sociale: - *Shërbime psikosociale për situatën e post-COVID për grupet në nevojë (të moshuarit, fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara), përfshirë këshillim dhe terapi psikologjike, mjekësore si edhe shërbime juridike, online;*
 - *Rritja e kujdesit për shtresat vunerabël e ato në nevojë, autik dhe Doën Syndrome, të rinjtë, adoloshentët, të moshuarit, viktimat e dhunës dhe të trafikimit si dhe çështjet e përfaqësimit të minoriteteve (rome, egjyptjan, LGBT, etj);*
 - *Informimi dhe sensibilizimi mbi të drejtat e të rinjve, kryesisht në zonat rurale;*
 - *Përmirësimi i shërbimeve sociale si dhe mbështetje për moshën e tretë, ofrimi i shërbimeve sociale në banesë;*
2. 2. Lufta kundër Korrupsionit dhe Edukimi Ligjor i Publikut dhe SKZHI (detyrim strategjik 20% ,10%, 10% e fondit qe do shperndahet) Në fushën e
 - *Prokurimeve;*
 - *Në fushën e Arsimit;*
 - *Në fushën e Shëndetësisë dhe*
 - *Zbatimit të Ligjit;*
 - *E drejta e informimit, akses në drejtësi, ndjekja e strategjive për përfshirjen e të rinjëve në qeverisje, transparencë e institucioneve publike;*
3. 3. Mjedisi, dhe Zhvillimi i qëndrueshëm: - *Mbrojtja dhe rehabilitimi i mjedisit; fuqizim i kapaciteteve për parandalimin dhe menaxhimin e situatave të emergjencave natyrore (përmbytjet, zjarret, tërmete etj.);*
 - *Aktivizmi dhe vullnetarizmi, faktorë të rëndësishëm në mbrojtjen e mjedisit;*
 - *Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të tij;*
 - *Mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe artistike përmes promovimit të librit, kinematografisë dhe artit;*
4. 4. Arsimi dhe Integrimi Evropian - *Integrimi evropian, integrimi ekonomik rajonal (ballkanik etj.), njohja e standardeve demokratike, diskutimi, debati, dialogu, mendimi ndryshe dhe aftësia për të dëgjuar; zhvillimi i ideve dhe nismave rajonale etj;*
 - *Prioritet fuqizimi i shoqatave të reja dhe rritja e kapaciteteve të tyre;*
 - *Stimulimi dhe nxitja e të Rinjëve për të qënë pjesë Aktive;*
 - *Përfshirja e Shoqërisë Civile në proceset e politik-berjes; përsa i takon reformave publike*


si dhe vendimarrjeve publike;
- Edukimi Mediatik Online;

Shperndarrja e Projekteve fituese sipas Fushave Prioritare për projektet fituese Thirrja Nr.15 (31 Maj-01 Korrik 2022)/ Grant Distribution for the winning projects (in lek) according to respective Priority Field in %
paraqitet sipas Tabelave/grafikut të mëposhtëm:

Tabela 1

NR	Fushat Prioritare/Priority Fields	Nr Projekteve	Shuma e financuar per secilin prioritet	Pesha Spcifike ne %
1	<p>1. Shëndetësia dhe Shërbimet Sociale: - Shërbime psikosociale për situatën e post-COVID për grupet në nevojë (të moshuarit, fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara), përfshirë këshillim dhe terapi psikologjike, mjekësore si edhe shërbime juridike, online;</p> <p>- Rritja e kujdesit për shtresat vunerabël e ato në nevojë, autik dhe Doën Syndrome, të rinjtë, adolishentët, të moshuarit, viktimat e dhunës dhe të trafikimit si dhe çështjet e përfaqësimit të minoriteteve (rome, egjiptjan, LGBT, etj);</p> <p>- Informimi dhe sensibilizimi mbi të drejtat e të rinjve, kryesisht në zonat rurale;</p> <p>- Përmirësimi i shërbimeve sociale si dhe mbështetje për moshën e tretë, ofrimi i shërbimeve sociale në banesë;</p>	13	20,000,000	<u>20.9</u>
2	<p>2. Lufta kundër Korrupsionit dhe Edukimi Ligjor i Publikut dhe SKZHI (detyrim strategjik 20% ,10%, 10% e fondit qe do shperndahet) Në fushën e</p> <p>- Prokurimeve;</p> <p>- Në fushën e Arsimit;</p> <p>- Në fushën e Shëndetësisë dhe</p> <p>- Zbatimit të Ligjit;</p> <p>- E drejta e informimit, akses në drejtësi, ndjekja e strategjive për përfshirjen e të rinjve në qeverisje, transparencë e institucioneve publike;</p>	9	13,800,000	<u>14.5</u>
3	<p>3. Mjedisi, dhe Zhvillimi i qëndrueshëm: - Mbrojtja dhe rehabilitimi i mjedisit; fuqizim i kapaciteteve për parandalimin dhe menaxhimin e situatave të emergjencave natyrore (përmbytjet, zjarret, tërmete etj.);</p> <p>- Aktivizmi dhe vullnetarizmi, faktorë të rëndësishëm në mbrojtjen e mjedisit;</p> <p>- Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të tij;</p> <p>- Mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe artistike përmes promovimit të librit, kinematografisë dhe artit;</p>	20	32,500,000	<u>34.0</u>
4	<p>4. Arsimi dhe Integrimi European</p> <p>- Integrimi evropian, integrimi ekonomik rajonal (ballkanik etj.), njohja e standardeve demokratike, diskutimi, debati, dialogu, mendimi ndryshe dhe aftësia për të dëgjuar; zhvillimi i ideve dhe nismave rajonale etj;</p> <p>- Prioritet fuqizimi i shoqatave të reja dhe rritja e kapaciteteve të tyre;</p> <p>- Stimulimi dhe nxitja e të Rinjve për të qënë pjesë Aktive;</p> <p>- Përfshirja e Shoqërisë Civile në proceset e politik-berjes; përsa i takon reformave publike si dhe vendimarrjeve publike;</p> <p>- Edukimi Mediatik Online;</p>	16	23,900,000	<u>25.0</u>
5	Projekte që prekin më shumë se një fushë prioritare/More than one field	4	5,300,000	<u>5.5</u>
Total		62	95,500,000	<u>100.0</u>

Grafiku 1



Siç mund të vërehet nga tabela dhe grafiku, prioriteti me përqindjen më të lartë të projekteve të zbatuara është ai nën fushën Prioritare Mjedisi, dhe Zhvillimi i qëndrueshëm: *Mbrojtja dhe rehabilitimi i mjedisit; fuqizim i kapaciteteve për parandalimin dhe menaxhimin e situatave të emergjencave natyrore (përmblytjet, zjarret, tërmete etj.); me një peshë specifike 34%*

Një zë tjetër i rëndësishëm i përqindjes së peshës specifike përbën Prioriteti Arsimi dhe Integrimi European

- *Integrimi evropian, integrimi ekonomik rajonal (ballkanik etj.), njohja e standardeve demokratike, diskutimi, debati, dialogu, mendimi ndryshe dhe aftësia për të dëgjuar; zhvillimi i ideve dhe nismave rajonale etj;*

- *Prioritet fuqizimi i shoqatave të reja dhe rritja e kapaciteteve të tyre;*

- *Stimulimi dhe nxitja e të Rinjëve për të qënë pjesë Aktive;*

- *Përfshirja e Shoqërisë Civile në proceset e politik-berjes; përsa i takon reformave publike si dhe vendimarrjeve publike;*

- *Edukimi Mediatik Online; me 25%*

Ndërkaq, kategoria më shumë se një prioritet / fushë në përgjithësi nga statistikat ka qenë një kategori që gjithnjë ka pasur një përqindje të lartë, pasi projektet kanë qenë të një natyre më të gjerë, por që për këtë thirrje kjo kategori është në përqindjedje më të ulur krahasimisht me vitet e tjera. Pra projektet kanë qenë më të orientuar në një prioritet të caktuar.

Shpërndarja territoriale sipas qarqeve administrative e projekteve fituese

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në mënyrë të vazhdueshme duke qenë se në filozofinë e saj e misionin e saj ka një shpërndarje të projekteve fituese sa më të gjerë në të gjithë territorin.

Në të njëjtën përjasje edhe në thirrjen e saj Nr. 14 të drejtuar OJF-ve për shprehje interesi për Projekt Propozime e ka pasur si objektiv kryesor një shpërndarje territoriale sa më të gjerë në nivel kombëtar.

Siç mund të vihet re nga të dhënat tabelave/grafikëve si dhe shpërndarjes në përqindje; por edhe asaj territoriale, Projektet fituese kanë një përqëndim më të lartë të zbatueshmërisë në rrethin e Tiranës.

Mbulimi për financim me projekte në përgjithësi prek të gjitha qarqet administrative. Mbulimin me përqindje më të lartë siç u përmend dhe më lartë e zë Qarku i Tiranës, më pas vijjnë qarqet Berat, Vlorë, Gjirokastrë, Elbasan, Durrës, Korçë etj.


Në mënyrë më të detajuar për këtë shpërndarje të dhënat shprehen në tabelat dhe grafikët e mëposhtëm:

TABELA Shpërndarja territoriale sipas qarqeve administrative e projekteve fituese për Thirrjen 15

Nr.	Viti 2022 TOTALI nr.projektesh per qarku per 2022	TOTALI Fondet ne Euro per qark per 2019-2022 [†]	
1	Qarku i Beratit	3	31,034
2	Qarku Dibër	2	15,517
3	Qarku Durrës	3	24,137
4	Qarku Elbasan	5	62,068
5	Qarku Fier	2	44,827
6	Qarku Gjirokastrë	1	15,517
7	Qarku i Korçë	7	82,758
8	Qarku Kukës	4	40,517
9	Qarku Lezhë	1	13,793
10	Qarku Shkodër	5	37,931
11	Qarku Tiranë	25	263,793
12	Qarku Vlorë	5	77,586
	Projekte në Nivel Kombëtar	3	50,172
TOTALI	TOTAL=932,071 Euro		TOTAL=744,148.5 Euro 1 Euro = 116 ALL

[†] Shenim: Kursi i Këmbimit date 14.12.2022
1 Euro = 116 ALL

Grafik: Shpërndarja territoriale sipas qarqeve administrative e projekteve fituese për Thirrjen 15



KAPITULLI III

Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI KOMBËTAR
PËR SHOQËRINË CIVILE**

Referuar nevojave dhe synimit për përafrimin e legjislacionit por jo vetëm, edhe strukturave shtetërore për funksionim edhe më të saktë të shoqërisë civile, Qeveria Shqiptare ndërmorri iniciativën për themelimin dhe organizimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile.

Misioni themelor i këtij Këshilli do të jetë garantimi i bashkëpunimit institucional me organizatat e shoqërisë civile në dobi dhe në funksion të zgjerimit të demokracisë.

Në vazhden e kësaj nisme, Qeveria Shqiptare, në fundvitin e 2015-ës, miratoi Ligjin Nr. 119/2015 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile”.

Përgjatë vitit 2022, Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC) ka organizuar dy mbledhje, përkatësisht më datë 22 Qershor 2022 dhe 15 Nëntor 2022.

Çështjet e diskutuara:

Mbledhja I:

- Analizë në lidhje me Monitorimin e Udhërrëfyesit 2019-2023, dhe Planin e Veprimit sipas drejtimeve strategjike;
- Prezantim mbi nismën për Partneriten për Qeverisjen e Hapur (OGP) dhe hapat e ardhshëm të Komitetit;
- Prezantimi i Ligjit nr. 36/2022 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Grupeve Vendore të Veprimit”;
- Diskutim mbi nevojën e koordinimit mes grupeve të punës për kryerjen e aktiviteteve që do të ndihmojnë në përmbushjen e prioriteteve të Udhërrëfyesit;
- Financimi i OSHC-ve;
- *Diskutimi i propozimeve të ardhura nga Shoqëria civile: (i) shtimin e një anëtari nga Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët në KKSHC; (ii) adresimin e çështjeve që lidhen me fiskalizimin dhe taksat vendore për organizatat jofitimprurëse me anëtarë të Ministrisë së Financave; dhe (iii) hartimin e një liste me personat e vendosur si pika kontakti për grupet e punës në ministritë përkatëse

Mbledhja II:

- Prezantimi i mundësive aktuale për bashkëpunim mes shoqërisë civile dhe nismës për Partneriten për Qeverisjen e Hapur (OGP);
- Prezantim mbi udhëzimet e DG NEAR për mbështetjen e Bashkimit Europian për shoqërinë civile 2021-2027;
- Diskutime mbi ngritjen dhe ndarjen e grupeve të punës së KKShC-së;
- Propozime për kalendarin e aktiviteteve të KKShC-së;

Komisioni Teknik i AMShC-së pranë KKShC-së në përfundim të afateve të vendosura shpall listën përfundimtare të kandidaturave për zgjedhjen e tetë anëtarëve përfaqësues të shoqërisë civile në Këshill, vakanca të krijuara për shkak të përfundimit të mandateve të cilat janë si më poshtë:

A. Demokratizimi, sundimi i ligjit, të drejtat e njeriut dhe integrimi në BE (2 vakanca);

1. Ergys Gezka
2. Gentian Serjani

B. Zhvillimi ekonomik territorialo-mjedisor (2 vakanca);

1. Ermelinda Mahmutaj
2. Mirela Koci

C. Përmirësimi i mirëqenies, shërbimeve sociale, mbrojtjes së shëndetit si dhe cilësisë së jetës (4 vakanca);

1. Fabiola Laco – Egro
2. Eglantina Bardhi
3. Indrit Seferi
4. Nensi Dragoti

Lista e përmbajtjes së Raportit të Monitorimit Financiar

1- Hyrje

2- Plani fillestar i Buxhetit Viti 2022

3- Rishikimi i Buxhetit për Vitin 2022 nëpërmjet Akteve Normative dhe shkresave specifike për rishikimet e buxhetit për nevojat e Institucionit dhe mbarevajtjes së punës

4- Analiza e realizimit të treguesve buxhetore për Vitin 2022

Hyrje

Në mbështetje të nenit 104 pika 4 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 65 të Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “ Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”(te ndryshuar), Nr.115/2021 “Për Buxhetin e Vitit 2022”, në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”, ju dergojme Raportin e Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit për Agjencinë për Mbështetje të Shoqërisë Civile për Vitin 2022.

1- Monitorim/ Vlerësimi i performancës së treguesve Buxhetore për Vitin 2022

Siç edhe dihet, Monitorimi në këtë rast është një proces vlerësimi performance i cili realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuara.

Pra, monitorimi është procesi që lidh realizimin e objektivave dhe produkteve me fondet përkatëse të planifikuara për arritjen e tyre.

Me anë të këtij relacioni/raporti monitorimi të Buxhetit të AMSHC - së për Vitin 2022, saktësojmë informacionin mbi efektivitetin e përdorimit të fondeve buxhetore dhe performancën e produkteve të realizuara për Vitin 2022 përse i përket **Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile**.

Në përdorimin e fondeve buxhetore, AMSHC –ja është mbështetur në parimet e menaxhimit dhe mirëfunksionimit të sistemit buxhetor.


Shpërndarja e burimeve financiare është bërë në përputhje me politikat ekonomike dhe prioritetet e AMSHC –së, duke pasur si synim një përdorim sa më eficient të këtyre burimeve, përgjegjësi të qarta për menaxhimin e shpenzimeve për çdo produkt, në funksion të realizimit të objektivave dhe aktiviteteve të përcaktuara nga Agjencia për Mbështetje të Shoqërisë Civile për vitin 2022.

2- Plani fillestar i Buxhetit Viti 2022

Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, *në mbështetje të Ligjit Nr.115/2021 “Për Buxhetin e Vitit 2022”* në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”, i është akorduar një fond i planifikuar prej **123,781,000 mijë lekë**, i detajuar si më poshtë (Tab.Nr.1) nga:

Tabela Nr.1
Plani fillestar i Buxhetit Viti 2022

Fondi i Pagave (zëri 600)	14,700,000	Lekë
Fondi i Sigurimeve Shoqërore (zëri 601)	2,600,000	Lekë
Fondi për Shpenzime Operative (zëri 602)	5,481,000	Lekë
Fondi për transfertat ndaj të tretëve (zëri 604)	100,000,000	Lekë
Fondi për Investimet e Trupëzuara (zëri 231)	1,000,000	Lekë
	123,781,000	Lekë



Duke vlerësuar konstatimet dhe sugjerimet e Ministrisë së Financave përsa I përket Përgatitjes së Fazës së Parë të PBA –së 2023-2025, vlerësojmë se Ekipi i Menaxhimit të Programit gjatë vitit 2022, ka bërë një punë të përgjegjshme në drejtim të respektimit të përcaktimeve të udhëzimit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm përshtatur specifikisht për natyrën e detyrave dhe përgjegjësiqë AMSHC mbulon në bazë të Ligjit mbi të cilin është krijuar dhe funksionon prej shumë vitesh tashmë.

- Së pari, në kuadër të pikës 3 të Udhëzimit nr.10, dt.28.02.2017 “Përfshirja e shoqërisë Civile në përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm”, ju vemë në dijeni se pjese e planeve të punës në baza vjetore për AMSHC- në, është gjithmone realizimi I takimeve konsultative me përfaqësues të Shoqërisë Civile në Shqipëri me qëllim njohjen me problematikat e hasura, me sugjerimet e tyre lidhur me organizimin e punës në Institucion, sugjerimet e tyre përsa I përket detajimit të zërave buxhetore si dhe përsa I përket aktiviteteve që janë të rëndësishme për t’u organizuar me qëllim përcjelljen e “feedback” të qartë të OJF-ve në punën tonë të përditshme si Institucion që mbështet fuqizimin e një Shoqërie Civile të qënësishme në vend.
- Së dyti, në vijim të punës për të realizuar me sukses buxhetimin gjinor, edhe AMSHC -ja përcaktuar produkte/objektiva/aktivitete/kosto të detajuara për arritjen e barazisë gjinore si dhe ka financuar dhe ndjekur projekte me këtë qëllim.

3- Rishikimi i Buxhetit per Vitin 2022 si dhe ndryshimet e ndodhura nga plani fillestar I BUXHETIT !

Akti Normativ nr.3, dt.12.03.2022

Mbështetur në Aktin Normativ Nr.3, datë 12.03.2022. “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.115/2021 “Për Buxhetin e Vitit 2022” dhe në zbatim të Udhëzimit të përhershme të Ministrit të Financave Nr.2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”, pakesimet per Agjencine per mbeshtetje te Shoqerise Civile pasqyrohen si më poshte vijon :

Detajimi sipas AN nr.3 date 12.03.2022										
Entit. Qev	Min. Linjës	K.Instit	Emërtimi i Institucionit	Kap	Prog.	Llog. Ekonom	Kodi D. së Thesarit	Kodi Produktit	Emërtimi i produktit	Shuma (Në lekë)
001	88	1088001	AMSHC	01	01110	6000000	3535	98801AA	Projekte te financuara nga AMSHC- ja	367,500
001	88	1088001	AMSHC	01	01110	6010000	3535	98801AA	Projekte te financuara nga AMSHC- ja	65,000
001	88	1088001	AMSHC	01	01110	6020000	3535	98801AA	Projekte te financuara nga AMSHC- ja	1,096,200
			TOTALI							1,528,700

Ndërkohë, për arsye të vijueshmërisë së monitorimeve në terren të projekteve të cilat financohen nga AMSHC –ja dhe nisur nga udhëtimet e punës të realizuara në muajin Shkurt 2022 nga AMSHC të tilla si Udhëtim pune në Rumani por edhe në Prishtinë /Kosovë, u bë e nevojshme që të kërkohej një rialokim fondi mes llogarive të AMSHC –së me konkretisht fondi prej 5,000,000 kaloi nga llogaria e granteve 604 te llogaria e shërbimeve dhe mallrave 602 te kodi 98801AB, fond i cili eshte perdorur kryesisht për mbulimin e shpenzimeve me karakter “monitorim/vlerësim në terren të projekteve financiar nga AMSHC” , si dhe për mbulimin e eventeve me qëllim rritje kapacitetesh teknike të OJF -ve si pjesë e qëllimit afatgjatë të punës së AMSHC- së në përgjithësi.

Gjithashtu, është shtuar në llogarinë 606 fondi prej 200,000 lekësh fond i cili eshte perdorur përgjatë vitit për stafin e AMSHC- së sipas legjislacionit që rregullon këtë pjesë si dhe u zbatua VKM -ja e shperblimit te stafit nr.898, date 29.12.2022 “Per mbeshtetjen financiare te menjehershme te punonjesve te qeverisjes se pergjithshme dhe institucioneve te arsimit te larte publik per zbutjen e impaktit te krizes”.

Me këto ndryshime në buxhetin e AMSHC –së sipas Aktit Normativ Iartpermendur, si edhe rialokimeve ndodhur me kërkesë të vet Institucionit fondi aktual i AMShC-së paraqitet si tabela poshtëshënuar :

Viti 2022

Tab ne
Leke

Ent.Qeverisje	Min Linjes	Kod Institucioni	Emer Institucioni	Kapitulli	Programi	Llog.Ekonomike	Kod Thesari	Shuma
SHTOHET								
01	88	1088001	AMSHC	01	01110	6060000	3535	350,000
PAKESOHET								
01	81	1081003	Fondi I veçante	01	04950	6090000	3535	350,000

**Rialokim fondi per llogarine e mallrave /sherbimeve Produkti
98801AB**

Viti 2022

Tab ne Leke

Ent.Qeverisje	Min Linjes	Kod Institucioni	Emer Institucioni	Kapitulli	Programi	Llog.Ekonomike	Kod Thesari	Shuma
SHTOHET								
01	88	1088001	AMSHC	01	01110	604	3535	5,000,000
PAKESOHET								
01	88	1088001	AMSHC	01	01110	602/Produkti 98801AB	3535	5,000,000
01	88	1088001	AMSHC	01	01110	601	3535	5,000,000

Pas ndryshimeve te kerkuar Plani i buxhetit perfundimtar per AMSHC –në per vitin 2022

eshte si më poshtë :

Plani i Buxhetit përfundimtar për AMShC-në – Viti 2022 pas ndryshimeve te ndodhura pergjatë vitit 2022

Fondi i Pagave (zëri 600)	14,332,500	Lekë
Fondi i Sigurimeve Shoqërore (zëri 601)	2,535,000	Lekë
Fondi për Shpenzime Operative (zëri 602)	9,348,800	Lekë
Fondi për transfertat ndaj të tretëve (zëri 604)	95,000,000	Lekë
Fondi për Transferta Familjare dhe Individët (zëri 606)	350,000	Lekë
Fondi për Investimet e Trupëzuara (zëri 231)	1,000,000	Lekë
	120,148,038	Lekë


Mbi detajimin e buxhetit te ketij viti duhet theksuar detajimi ne dy produkte i buxhetit akorduar AMSHC –se, te tilla si 98801AA si dhe 98801AB ku produktet te parashikuara ne PBA e Vitit 2022 sipas formateve te reja kane qene dy te tilla si : Projekte te financuara nga AMSHC –ja si dhe Monitorime/Inspektive ne terren.

➤ Programi “Mbështetje për Shoqërinë Civile

Ecuria e realizimit buxhetor per Vitin 2022

Struktura Buxhetore	Shpenzimet Progresive Fakt	Plani Vjetor sipas ndryshimeve te bera gjate vitit	Realizimi ne Perqindje
600 - Llogaria e pagave	13,729,191	14,332,500	96 %
601 - Kontribute sig shoq shend	2,209,901	2,535,000	87 %
602 - Shpenzime te tjera Korrente	9,384,800	8,283,856	88 %
604/1 - Tranferta GRANTE	94,856,292	95,000,000	100 %
231 - Investimet te brendshme	868,798	1,000,000	87 %
606- transferta familjare dhe individet	200,000	350,000	57 %
Totali	120,148,038	122,602,300	97 %

Ecuria e realizimit buxhetor për vitin 2022



4- Analiza e realizimit te treguesve buxhetore per Vitin 2022 !

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqerore (zeri 600-601), është **realizuar** në zbatim të Strukturës Organizative të miratuar me Vendim nr. 769 datë 15.07.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Statutit të Agjencisë Për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”. Ndryshuar me Vendimin nr. 789 datë 16.11.2011 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në Vendimin nr. 769 datë 15.07.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, Nr.115/2021 “Për Buxhetin e Vitit 2022”, në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”, sipas Vendimit në zbatim të VKM –së Nr.35, dt. 19.01.2022 “Për Përcaktimin e numrit të Punonjësve me kontratë të përkohshme për Vitin 2022 në njësitë e Qeverisjes Qendrore” numri mesatar i punonjësve për AMSHC -në është realizuar 16 punonjës të përhershëm si dhe dy punonjës me kontratë të përkohshme. Nga fondi i përgjithshëm i pagave dhe shpërblimeve, si dhe i sigurimeve shoqërore, gjatë këtij viti, është realizuar respektivisht;

- **13,729,190 Lekë** (zeri 600) për paga, realizimi **95 %**.
- **2,209,900 Lekë** (zeri 601) për kontribute për sigurimet shoqërore shendetsore, realizimi **87 %**.
- Shpenzimet e Personelit janë realizuar në vlerën **15,939,090 lekë në total dhe 94 % me përqindje** që do të thote që është një realizim shumë i mirë i fondit të pagave dhe sigurimeve për Vitin 2022.

Fondi për shpenzime të tjera korrente (zeri 602), për vitin 2022, është planifikuar fillimisht me Ligjin e Buxhetit të Vitit 2022 në vlerën **5,481,000 leke**.

Në këtë zë buxhetor është mbështetur edhe veprimtaria dhe aktivitetet e KKSHC- së nisur edhe nga detyrat që AMSHC –ja ka përmbushur si Sekretariat i Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile duke mbuluar aktivitetet e KKSHC –së si dhe për të siguruar facilitetet logjistike për organizimin e mbledhjeve të KKSHC –së.

Ofrimi i asistencës ligjore në finalizimin e Udhërrëfyesit për Shoqërinë Civile ku AMSHC ndërmori një rol të rëndësishëm në hartimin dhe mirëpërcaktimin e planit të punës dhe më gjerë. Për këtë funksion, AMSHC gjithashtu ndërmori një sërë masash me qëllim realizimin sa më të saktë të tij duke përthithur produktin final (miratimin dhe zbatimin e Udhërrëfyesit). Në kuadër të zbatimit të këtij Udhërrëfyesi të rishikuar, janë specifikuar detyrat për çdo Institucion dhe aktorë të Shoqërisë Civile të përfshirë. AMSHC –ja së bashku me Kryeministrinë ka edhe detyren e rëndësishme të monitorimit të zbatimit të Udhërrëfyesit për një mjedis mundësues të Shoqërisë Civile si mekanizmi dhe plani kryesor i punës për të lehtësuar dhe mundësuar aktivitetin e OJF- ve në vend.

Roli aktiv i AMSHC- së në Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit është një tjetër arritje e Institucionit duke ndikuar sadopak në plotësimin e masave dhe indikatorëve sa i përket Qasjes Ndërgjegjësuese. Për këtë qëllim, AMSHC ka tashmë programin e saj Institucional kundër Korrupsionit, një buxhet të dedikuar për projektet anti- korrupsion. Në zërin buxhetor të AMSHC – së , disa shpenzime janë dedikuar edhe kësaj strategjie.

Pas rialokimeve të fondit për llogari të zërit 602 Totali i këtij zeri për vitin ishte 9,384,800 leke.

Edhe për këtë zë, për gjatë vitit 2022 është realizuar vlera prej **8,283,856 Lekë ose 99 %** e planit vjetor të rishikuar për AMSHC –në, disa shpenzime të planifikuara ose evente të KKSHC-së nuk u realizuan,

Një arsye tjetër për këtë rezultat faktik të shpenzimeve të zërit shpenzime, mirëmbajtje llogaria 602 janë edhe procedurat e prokurimeve online ku është synuar gjithmonë për çmimin më të ulët për blerjet në kuadër të logjistikës së përgjithshme për ecurinë normale të punës në Institucion.

Në realizimin e shpenzimeve operative, AMSHC –ja është mbështetur në parimin e një shpërndarje sa më racionale të kërkesave për ecurinë optimale të veprimtarisë së Institucionit si dhe ka zbatuar “*Rregjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike për Vitin 2022*” për blerje dhe shërbime të cilat kryesisht lidhen me;

- Realizimin e shpenzimeve, të detyrueshme ndaj shtetit, si detyrime taksa e tatime, energji elektrike, ujë, shërbime postare e telefonike, në funksion të një veprimtarie normale institucionale.
- Kyerjen e të gjitha blerjeve për nevoja të AMSHC-së, publikime, blerje kancelarike, riparime automjeti, lysterje dhe mirembajtje, pastrim etj.
- Kryerjen e pagesave për likuidimin e detyrimeve furnitorë dhe të tretë etj.
- Kryerjen e monitorimeve në terren të projekteve që AMSHC ka financuar gjatë vitit 2022.
- Realizimin e study tour në vende të rajonit për shkëmbimin e eksperiencave më të mira për zhvillimin dhe mbështetjen e shoqërisë civile.

Realizimi i plotë i fondit për Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes argumentohet me arsyet si më poshtë vijon:

- Së pari, gjatë vitit 2022 janë realizuar pjesa më e madhe e praktikave të prokurimeve të parashikuara në Rregjistrin e Prokurimeve Publike dhe gjithashtu janë realizuar programet e punës përsa i përket monitorimeve në terren të projekteve që AMSHC – ja ka financuar dhe monitoruar gjatë vitit 2022 duke zbatuar legjislacionin përsa i takon Urdhër shërbimeve dhe Udhëtimeve të punës me qëllim monitorimin në terren të projekteve të OJF-ve financuar nga AMSHC –ja.

Fondi në zërin për Transferime Korrente të Brendshme (zeri 604), për vitin 2022 është planifikuar në vlerën **95,000,000 leke**.

Ky është dhe zëri më me peshë në strukturën e buxhetit të AMSHC- së, duke qenë se dhe vete Misioni i këtij Institucioni ka si qëllim kryesor financimin e Shoqërisë Civile me Grante për projektpropozimet e OJF përfituese.

Edhe për këtë zë, aktualisht **604 Kapitulli 1** për periudhën respektive është realizuar vlera prej **94,856,290 Lekë** ose **99 % e planit vjetor**.

Ndërkohë disbursimet e zërit të Granteve kanë përfshirë disbursime nga Thirrja Nr14, dhe në gjysmën e dytë të Vitit fiskal 2022 janë disbursuar Projektet fituese të Thirrjes Nr.15 organizuar nga AMSHC-ja të cilat janë aktualisht në zhvillim dhe pritet të përfundojnë përgjatë vitit 2023.

5- Ecuria e disbursimeve të granteve financiare

Në Tabelën më poshtë, evidentohet **ecuria e disbursimeve të granteve financiare**

(Llogaria 604 –Disbursimi I Granteve) sipas muajve gjatë vitit 2022, si dhe në grafikun më poshtë qartësohet kjo ecuri disbursimi në formë grafiku ku shihet që disbursimet e granteve më së shumti

janë përqendruar në muajin Shtator 2022 pas shpalljes së OJF- ve fituese të Thirrjes nr.15 si dhe në Dhjetor ku sipas përcaktimeve të kontratave lidhur mes OJF -ve dhe AMSHC- së.

Fondi per shpenzim investime (zeri 231),

1,000,000 Lekë (zeri 231) për Investime të Trupëzuara,

Gjatë tre mujorit të katërt të vitit 2021, janë finalizuar edhe praktikat e prokurimit dhe ndjekjes përse i përket fondit të investimeve. Në total për këtë zë janë disbursuar **811,440 leke që përbëjnë 81% të fondit të Investimeve.**

Pjesa e parealizuar e fondit të Investimeve arsyetohet me ndjekjen e procedurave online të Prokurimeve publike dhe lidhjes së kontratave me çmimin më të ulët. Investimet këtë vit kanë shkuar për përmirësimin e rrjetit të IT –së në Institucion, për përmirësimin e gjendjes së ambienteve të brendshme të zyrave etj.

AMSHC është një Institucion qendror buxhetor i krijuar me Ligjin Nr. 10093 Date 09.03.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile” dhe VKM Nr. 769 Date 15.07.2009 “Per Miratimin e Statutit te AMSHC-se” (I ndryshuar), me Mision themelor **“Nxitjen e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Shoqërisë Civile”**, si dhe **“Krijimin e kushteve të favorshme për nisma civile”**, në të mirë dhe në interes të publikut.

Për realizimin e Misionit, AMSHC-ja ofron **“asistencë financiare”** për programet, që nxisin e forcojnë qëndrueshmërinë e organizatave jofitimprurëse, bashkëpunimin ndërsektorial e ndërkombëtar, nismat civile, filantropinë, vullnetarizmin e institucionet demokratike të shoqërisë, si dhe programe të tjera si

trajnime/workshops/konferenca/takime rajonale që lehtësojnë përmbushjen e misionit të saj.

Duke filluar nga **muaji Nëntor 2010 e deri në fund të vitit 2022** Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile udhëhequr nga Bordi Mbikqyrës I AMSHC- së, ka organizuar **15 Thirrje për ProjektPropozime** sipas prioriteteve dhe fushave të cilat janë objektiva të përhershëm të Institucionit, dhe janë kryer procedurat e duhura konform Ligjeve në fuqi në lidhje me njoftimin, shpalljen, vlerësimin, seleksionimin dhe kontraktimin e Organizatave Jofitimprurëse për financimin me Grante të projekteve që kanë rezultuar fituese. Më tej puna konkrete e AMSHC- së si Institucion, mbetet ndjekja e Projekteve deri në fazën finale të realizimit të tyre, Monitorimi dhe Vlerësimi I ecurisë së realizimit të Aktiviteteve konform projektpropozimit dhe kontratës së lidhur mes palëve si dhe Monitorimi dhe Vlerësimi i ecurisë së realizimit financiar të Projekteve të financuara nga AMSHC- ja dhe përputhshmëria me buxhetin e parashikuar si dhe me legjislacioni fiskal dhe tatimor të Republikës së Shqipërisë.

Sasia e granteve dhe Organizatave Jofitimpruese (shkurt OJF) te kontraktuara për t'u Financuar për secilën Thirrje të organizuar nga AMSHC paraqitet si vijon:

Tabela 4 (ne Leke):

Thirrja	Numri i OJF-ve Perfituese	Vlere e Granteve financiare (ne Leke)
Thirrje Nr.1	52	125,918,000
Thirrje Nr.2	31	16,000,000
Thirrje Nr.3	69	131,960,000
Thirrje Nr.4	63	62,105,000
Thirrje Nr.5	47	55,200,000
Thirrje Nr.6	21	43,755,840
Thirrje Nr.7	41	73,500,000
Thirrje Nr.8	18	36,000,000
Thirrje Nr.9	41	85,200,000
Thirrje Nr.10	35	95,100,000
Thirrje Nr.11	45	107,700,000
Thirrja Nr.12	52	115,600,000
Thirrja Nr.13	46	41,230,000
Thirrja Nr.14	72	108,650,000
Thirrja Nr.15	62	95,500,000
TOTAL	695	1,193,418,840

KAPITULLI V

Veprimtarit e AMSHC-së përgjatë vitit 2022:



18 Tetor 2022 Torino, Itali.

Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) z. Andi Kananaj pjesë e panelit në Workshopin me temë “Civil Society Organisations and Human Capital Development in the Context of Lifelong Learning” të organizuar nga European Training Foundation (ETF)

Seminari do të fokusohet në atë që po bëhet dhe çfarë është ende e nevojshme për tu bërë që Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) të njihen si aktorë relevantë në proceset e politikave të të mësuarit gjatë gjithë jetës si dhe rritja e dialogut me rrejet e OSHC-ve

(31.05.2022- 01.07.2022)

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), në kuadrin e konkurimit të hapur dhe transparent sipas kriterëve të përcaktuara në Ligjin Nr. 10 093, datë 09.03.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, në përputhje me statutin dhe misionin e saj: Asistencë Financiare për një zhvillim të qëndrueshëm të shoqërisë civile dhe krijimin e kushteve të favorshme për nisma qytetare në të mirë dhe interes të publikut; shpall këtë Thirrje për Shprehje Interesi për të gjitha OJF-të e interesuara për projekte.

Projekt -propozime mbuluan fushat prioritare:

1. Shëndetësia dhe Shërbimet Sociale:

- Shërbime psikosociale për situatën e post-COVID për grupet në nevojë (të moshuarit, fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuar), përfshirë këshillim dhe terapi psikologjike, mjekësore si edhe shërbime juridike, online;
 - Rritja e kujdesit për shtresat vunerabël e ato në nevojë, autik dhe Doën Syndrome, të rinjtë, adoloshentët, të moshuarit, viktimat e dhunës dhe të trafikimit si dhe çështjet e përfaqësimit të minoriteteve (rome, egjiptjan, LGBT, etj.);
 - Informimi dhe sensibilizimi mbi të drejtat e të rinjve, kryesisht në zonat rurale;
 - Përmirësimi i shërbimeve sociale si dhe mbështetje për moshën e tretë, ofrimi i shërbimeve sociale në banesë;
2. **Lufta kundër Korrupsionit dhe Edukimi Ligjor i Publikut dhe SKZHI** (detyrim strategjik 20% ,10%, 10% e fondit që do shpërndahet)

Ky prioritet është në kuadër nga detyrimet që vijnë nga marrveshjet ndër-institucionale të tilla si Strategjia Ndersektoriale Kundër Korrupsionit, Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut dhe Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim;

- Në fushën e Prokurimeve;
- Në fushën e Arsimit;
- Në fushën e Shëndetësisë dhe
- Zbatimit të Ligjit;
- E drejta e informimit, akses në drejtësi, ndjekja e strategjive për përfshirjen e të rinjve në qeverisje, transparencë e institucioneve publike;

3. **Mjedisi, dhe Zhvillimi i qëndrueshëm:**

- Mbrojtja dhe rehabilitimi i mjedisit; fuqizim i kapaciteteve për parandalimin dhe menaxhimin e situatave të emergjencave natyrore (përmytjet, zjarret, tërmete etj.);
- Aktivizmi dhe vullnetarizmi, faktorë të rëndësishëm në mbrojtjen e mjedisit;
- Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të tij;
- Mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe artistike përmes promovimit të librit, kinematografisë dhe artit;

4. **Arsimi dhe Integrimi European**

- Integrimi evropian, integrimi ekonomik rajonal (ballkanik etj.), njohja e standardeve demokratike, diskutimi, debati, dialogu, mendimi ndryshe dhe aftësia për të dëgjuar; zhvillimi i ideve dhe nismave rajonale etj;
- Prioritet fuqizimi i shoqatave të reja dhe rritja e kapaciteteve të tyre;
- Stimulimi dhe nxitja e të Rinjve për të qënë pjesë Aktive;
- Përfshirja e Shoqërisë Civile në proceset e politik-berjes; përsa i takon reformave publike si dhe vendimarrjeve publike;
- Edukimi Mediatik Online;

Projekt-propozimet duhet të shoqërohen me dokumentet e mëposhtme:

1. **Formulari i plotësuar i aplikimit**, i vulosur dhe i nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i Organizatës (Formulari duhet firmosur në çdo faqe);
2. Fotokopje të **Vendimit të Regjistrimit të Gjykatës dhe Statutit të Organizatës**;
3. **Ekstrakti i Gjykatës** (i cili merret në Zyrën e Regjistrimit të OJF-ve, pranë Gjykatës së Qarkut, Tiranë)- origjinal brenda 3-mujorit referuar datës së mbylljes së afatit të aplikimit;
4. **NIPT-i** (i noterizuar) brenda 3-mujorit referuar datës së mbylljes së afatit të aplikimit;

5. **Vërtetim nga Drejtoria e Tatim Taksave** (që Organizata nuk ka detyrime të pashlyera përse u përket kontributeve për sigurimet shoqërore, shëndetësore) – origjinal ose me vulë digjitale (i shkarkuar nga shërbimi ëëë.e-albania.al) brenda 3-mujorit referuar datës së mbylljes së afatit të aplikimit;
6. **Vërtetim bankar** (ku pasqyrohen numri IBAN dhe numri i llogarisë së Organizatës, në lekë) – brenda 3-mujorit referuar datës së mbylljes së afatit të aplikimit;
7. **CV të Organizatës** (të firmosur dhe vulosur nga përfaqësuesi ligjor i OJF-së) dhe Licencën e lëshuar nga autoritetet publike në rast se ka aktivitetete të parashikuara në projekt, të cilat nuk mund të kryhen pa zotëruar Licencën përkatëse (për shembull: në rastet kur projekt-propozimet kanë aktivitetete që kërkojnë ekspertizën e psikologut, ky i fundit duhet të ketë licensë për të kryer këtë funksion);
8. **Deklaratë/Marrëveshje Partneriteti** (origjinale ose fotokopje të noterizuar, në rast se ka partneritet në këtë projekt-propozim);

Data 22.06.2022

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në rolin e sekretariatit teknik për Këshillin Kombëtarë të Shoqërisë Civile organizoi në datën 22 Qershor 2022 në orën 15:00, në ambjentet e Sallës Ovale në katin e III në Kryeministri, mbledhjen e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile.

Mbi konsultimin publik në lidhje me prioritetet e thirrjes së rradhës:

Në zbatim të Ligjit Nr.10 093, datë 09.03.2009 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Agjencisë për Mbështetje të Shoqërisë Civile”; të Ligjit Nr. 146/ 2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, Agjencia për Mbështetje të Shoqërisë Civile realizoi takimet konsultative nëpër disa vende kryesore të Republikës së Shqipërisë. Qëllimi i takimeve kishte të bënte me procesin e përcaktimit të prioritetëve të Thirrjes së rradhës.

Shpërndarja u realizua si më poshtë vijon:

Realizimin e takimit konsultativ me Organizata Jofitimpruese në Qytetin e Vlorës në datën 08-11-2022 deri në 11-11-2022;

Realizimin e takimit konsultativ me Organizata Jofitimpruese në Qytetin e Korçës në datën 14-11-2022 deri 17-11-2022;

Realizimin e takimit konsultativ me Organizata Jofitimpruese në Qytetin e Sarandës në datën 21-11-2022 deri 24-11-2022;

Realizimin e takimit konsultativ me Organizata Jofitimpruese në Qytetin e Tropojës në datën 05-12-2022 deri në 08-12-2022;

Datë 17 qershor 2022



Përfaqësues nga AMSHC-ja pjesë e panelit në Konferencën Kombëtare për Shqipërinë e projektit "SMART Balkans – Shoqëria civile për vlera të përbashkëta në Ballkanin Perëndimor për çështjet e Qeverisjes së mirë dhe Integrimi Evropian të Shqipërisë dhe Ballkanit Perëndimor.

Datë 14 Nëntor 2022



AMSHC ka zhvilluar takimin me përfaqësues të organizatave të Shoqërisë Civile në kuadër të programit të akademisë së OJF-ve. Akademia është program 9 mujor i dedikuar për drejtues dhe menaxher të lartë të OSHC-ve, i cili synon rritjen e kapaciteteve të tyre në menaxhimin organizativ dhe zhvillimin e qëndrueshëm të organizatave.

Datë 15 nëntor 2022

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në rolin e sekretariatit teknik për Këshillin Kombëtar të Shoqërisë Civile organizoi në datën 15 Nëntor 2022, në ambjentet e Sallës Ovale në katin e III në Kryeministri, mbledhjen e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile.

Përgjatë datave 16.11.2022- 16.12.2022

PROCES I ZGJEDHJEVE
për tetë anëtarë të rinj nga shoqëria civile për
Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile

Vakancë e krijuar për shkak të përfundimit të mandateve

- 2 (dy) anëtarë – Fusha e veprimit A.
- 2 (dy) anëtarë – Fusha e veprimit B.
- 4 (Katër) anëtarë – Fusha e veprimit C.

Për më shumë informacion: www.amshc.gov.al/kkshc

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në rolin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile, nis procesin e përzgjedhjes së 8 (tetë) vakancave të krijuara për anëtarët e Shoqërisë civile në KKSHC.

Vakancë e krijuar për shkak të përfundimit të mandateve :

- 2 (dy) anëtarë – Fusha e veprimit A. Demokratizimi, sundimi i ligjit, të drejtat e njeriut dhe integrimi në BE;
- 2 (dy) anëtarë – Fusha e veprimit B. Zhvillimi ekonomiko-territorialo-mjedisor;
- 4 (Katër) anëtarë – Fusha e veprimit C. Përmirësimi i mirëqenies, shërbimeve sociale, mbrojtjes së shëndetit si dhe cilësisë së jetës;

Kriteret Për Kandidatët Dhe Dokumentacionet Mbështetëse:

1. Dokumentet që duhen dorëzuar nga organizatat që nominojnë kandidatët:
 - Formulari i Aplikimit, i publikuar nga AMSHC
 - Kopje e dokumentit të regjistrimit në Gjykatë
 - Konfirmim nga zyra e tatimeve që organizata e ka statusin “aktiv”
2. Kriteret që duhen përmbushur nga kandidatët për KKSHC:
 - Të ketë të paktën 3 (tre) vjet eksperiencë në rol drejtues në organizata të shoqërisë civile në fushën ku kandidon;
 - Të mos ketë role koordinuese ose drejtuese në organizata politike ose parti politike;
3. Dokumentet që duhen dorëzuar nga të nominuarit:
 1. Jetëshkrimi (CV – Curriculum Vitae);

2. Letër motivimi nga kandidati për të shpjeguar kontributin që mund të japë pranë KKSHC-së
3. Letër konfirmuese nga organizata e shoqërisë civile se kandidati ka të paktën 3 (tre) vite eksperiencë në fushën ku kandidon;
4. Pesë letra mbështetëse nga organizata të tjera të cilat mbështesin kandidatin;

Për shkakë të të paturit të konkurrencës së lartë në proces komisioni teknik i KKSHC-së vendosi shtyrjen e afatit për aplikime deri në datën 27 dhjetor 2022.

30 Nëntor 2022

Përfaqësues nga AMSHC pjesë e takimit të komitetit shumëpalësh për qeverisje të hapur gjatë të cilit u realizua:

- U miratua Raporti i vetë vlerësimit të planit të veprimit për 2020-2022
- U miratua rregullorja e brendshme e veprimtarisë së komitetit
- U caktua afati për caktimin e Bashkëkryetarit të komitetit si përfaqësues i OSHC.
- U dakordësua për caktimin e afateve për dërgimin e ideve, propozimeve në kuadër të planit të veprimit.

Në datat 05.12.2022- 20.12.2022



Samiti për Demokraci është një nismë globale e ndërmarrë për herë të parë në vitin 2021 nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara, me Presidentin Biden që organizoi liderët botërorë në një mbledhje në datat 9-10 dhjetor 2021 drejt rinovimit demokratik global, që mbledhi së bashku qeveritë, autoritetet, mediat, akademinë, sektorin e biznesit dhe Shoqërinë civile në mbarë botën për mbrojtjen e demokracisë si sfida përcaktuese e kohës sonë.

Përgjatë vitit 2022 si “Viti i Veprimit” të Samitit, platformat me shumë palë të interesuara kanë lançuar të quajtura Kohorte Demokracie, për të ndërmarrë veprime të bashkërenduara drejt zbatimit të angazhimit në fushat me interes të përbashkët. Kohorta e Demokracisë për Antikorrupsionin në të cilën Shqipëria është një vend partner, do të bashkojë qeveritë dhe autoritetet që demonstrojnë vullnet politik drejt përparimit në angazhimet e Samitit në fushën e luftës kundër korrupsionit, së bashku me kritikën konstruktive dhe kontributin e organizatave kryesore joqeveritare. Kohorta do të bashkëdrejtohet nga disa qeveri dhe autoritete dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Procesi do të ofrojë mundësi për dialog dhe bashkëpunim kuptimplotë ndërmjet përfaqësuesve të shoqërisë civile, drejtuesve të sektorit privat, partnerëve filantropikë, akademikëve dhe vendimmarrësve të qeverisë për çështje jetike për qeverisjen e mirë dhe rinovimin demokratik.

Për të mundësuar kontributin kuptimplotë të Shqipërisë në Samitin dhe Kohortën kundër Korrupsionit, Qeveria Shqiptare fton të gjitha Organizatat e Shoqërisë Civile të interesuara të paraqesin aplikimin e tyre për 3 vendet vakante përfaqësuese shqiptare nga sektori i OJF-ve. OSHC-të aplikante duhet të plotësojnë kriteret e renditura si më poshtë:

- Organizatat e Shoqërisë Civile duhet të jenë të regjistruar në përputhje me kuadrin ligjor shqiptar;

- Nuk duhet të jenë degë e një organizate ndërkombëtare që vepron në Shqipëri;
- Veprimtaria e tyre duhet të tejkalojë rëndësinë lokale/rajonale në operacionet dhe implementimet e saj për avancimin e luftës kundër korrupsionit në Shqipëri;
- OShC-të duhet të kenë të paktën 5 vjet eksperiencë të dëshmuara të kontributit në drejtim të aktivizimit/promovimit/monitorimit/kërkimit/raportimit/advokimit/proceseve gjyqësore në lidhje me aspekte të luftës kundër korrupsionit në vend.

*Të gjitha njohuritë, ekspertiza dhe aktivitetet e mëparshme rajonale dhe ndërkombëtare do të konsiderohen si avantazh.

OShC-të aplikuese duhet të dorëzojnë në mënyrë elektronike në adresën e postës elektronike info@amshc.gov.al dokumentacionin e mëposhtëm:

Portofoli i përditësuar i ekspertizës;

- Pesë (5) letra mbështetëse nga organizata të tjera të cilat mbështesin kandidatin;
- Letër motivimi;
- Projekte/ publikime /raporte/vendimeve gjyqësore të tyre (në rastet e çështjeve gjyqësore) dhe të gjitha vërtetimet e tjera të veprimtarisë së tyre në fushën e luftës kundër korrupsionit për të paktën 5 vjet, sipas kriterëve të aplikimit;

Aplikimet do të vlerësohen në bazë të dokumentacionit të dorëzuar dhe fituesit do të shpallen në faqen zyrtare www.amshc.gov.al

Shtyhet afati i aplikimeve për një konkurrencë më të lartë deri në datën 07.01.2023.

- Në kuadër të procesit të financimit me grante të organiztave të shoqërisë Civile AMSHC është pjesë e procesit të monitorimit të aktiviteteve që Organizatat e financuara realizojnë.